

31999R0955

Rregullore (KE) nr. 955/1999 e Parlamentit European dhe Këshillit, datë 13 prill 1999, që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2913/92 në lidhje me procedurën e kalimit tranzit të jashtëm

Gazeta Zyrtare 119 , 07/05/1999 fq. 0001 - 0004

Rregullore (KE) nr. 955/1999 e Parlamentit European dhe Këshillit, datë 13 prill 1999, që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr 2913/92 në lidhje me procedurën e kalimit tranzit të jashtëm

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,
Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik European dhe në veçanti nenet 28, 100 (a) dhe 113 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 189 pika (b) të Traktatit [3]:

- (1) Duke pasur parasysh se procedura e kalimit tranzit të jashtëm siç rregullohet nga Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92 e 12 tetorit 1992, që themeloi Kodin Doganor të Komunitetit [4], është hartuar kryesisht për të lehtësuar tregtinë e mallrave që nuk bëjnë pjesë në Komunitet, në territorin doganor të komunitetit; duke pasur parasysh se nevoja për mbështetjen e kësaj procedure për eksportin e mallrave të komunitetit duhet të vlerësohet në lidhje me shumë situata të ndryshme; ndërsa është e nevojshme, që në çdo rast të mos lejohen produktet të cilat mbulohen ose që përfitojnë nga masat e eksportit që të mos shkelin ose përfitojnë pa arsye nga këto masa, duke siguruar se legjislatura doganore e Komunitetit e marrë si një e tërë, të garantojë kontrollin dhe monitorimin, të paktën të njëjtë me atë të ofruar nga procedura e kalimit transit të jashtëm të komunitetit; nëse ruhet mundësia për të përdorur këtë procedurë, në disa nga këto situata, atëherë përcaktimi i këtyre situatave përbën një çështje për procedurën e Komitetit;
- (2) Duke pasur parasysh se, të gjitha vendimet e marra sipas procedurës së komisionit duhet të jenë transparente si për administratat doganore edhe për operatorët ekonomikë;
- (3) Duke pasur parasysh se është e nevojshme të përcaktohet mënyra me anë të së cilës autoritetet doganore shfuqizojnë procedurën në lidhje me kohën, vendin dhe kushtet sipas të cilave përfundon procedura, në mënyrë që të përcaktohet më qartë qëllimi dhe kufiri i detyrimeve të mbajtësit të procedurës së kalimit transit të jashtëm dhe të sigurojë, në mungesë të informacionit që vendos, se procedura ka përfunduar, mbajtësi mbetet plotësisht përgjegjës; duke pasur parasysh se është e nevojshme, me

qëllim që të rritet sigurimi dhe efikasiteti i procedurës së kalimit tranzit, të përmirësohet shfuqizimi i procedurës me anë të masave vepruese dhe zbatimit të klauzolave, në atë mënyrë që përcaktimi të bëhet në përputhje me procedurën e Komisionit ,duke u siguruar se autoritetet doganore do të shfuqizojnë procedurën brenda një afati sa më të shkurtër;

- (4) Duke pasur parasysh se është e nevojshme që të përcaktohen më mirë rregullat për garanci në kalimin tranzit, duke përfshirë adresimin në forma të ndryshme garancie dhe rastet kur hiqet dorë nga garancia, në veçanti ,në vijim të amendamentit, atë që trajton rastin e kalimit tranzit detar; duke pasur parasysh se për të siguruar një mbrojtje të duhur të interesave financiare të Shteteve Anëtare dhe Komunitetit pa vendosur një detyrim të pabarabartë mbi përdoruesit, kjo garanci dhe llogaritja e shumës së saj duhet të bazohen mbi sigurinë e operatorit dhe rreziqeve lidhur me mallrat; duke pasur parasysh se një paraqitje më logjike dhe më mirë e strukturuar të dispozitave, është e përshtatshme në lidhje me garancinë gjatë kalimit tranzit;
- (5) Duke pasur parasysh se ,me qëllim që të ruhen të ardhurat e Komunitetit Evropian dhe të Shteteve Anëtare dhe të frenohen praktikat mashtruese në procedurën e kalimit tranzit, këshillohen marrëveshje që përfshijnë masa të shkallëzuara për zbatimin e garancisë gjithëpërfshirëse; duke pasur parasysh se është shqetësuese të merret në konsideratë dekreti për reduktimin e garancisë gjithëpërfshirëse, kur ekziston një rritje e rrezikshmërisë së mashtrimit si dhe e humbjes së të ardhurave; duke pasur parasysh se kur vendoset se ekzistojnë situata të veçanta kritike, të cilat mund të shfaqen në veçanti nga aktivitetet e krimeve të organizuara ,atëherë duhet të mundësohet përkohësisht ndalimi i zbatimit të vetë garancisë gjithëpërfshirëse; duke pasur parasysh se duhet të mbahen të dhëna gjatë zbatimit të këtyre masave të shkallëzuara të situatës së veçantë, të operatorëve ekonomikë, të cilët ndeshen me kriteret e ndryshme për të cilat duhet të vendosin kur duhet të sigurohet garancia individuale në vend të asaj gjithëpërfshirëse, atëherë detyrimet e operatorëve duhet të reduktohen nëpërmjet thjeshtësimeve më të mundshme;
- (6) Duke pasur parasysh se, procedurat e thjeshtuara që kanë ekskluzivisht një qëllim kombëtar të dyanshëm ose të shumanshëm të paraqitur nga Shtetet Anëtare sipas nenit 97 pika (2) të Kodit Doganor të Komunitetit, më poshtë quajtur “Kodi”, ndryshojnë shumë në natyrë dhe në disa raste mund të hyjnë në konflikt me zbatimin e procedurës së kalimit tranzit të Komunitetit dhe me nevojën për një trajtim të njëjtë të operatorëve ekonomikë, duke pasur parasysh se pa përmendur përfitimet që ky sistem i ofron këtyre operatorëve, duhet të sigurohet që Komisioni të vihet në dijeni për procedurat e thjeshtësuara të paraqitura nga çdo shtet anëtar mbi këto baza ,në mënyrë që të garantohet transparenca e këtyre masave dhe të vlerësohet pajtueshmëria e tyre me rregullat që drejtojnë procedurat e kalimit tranzit të komunitetit dhe në veçanti garancinë;
- (7) Duke pasur parasysh se, sistemet e sigurisë për procedurat e kalimit tranzit të Komunitetit , mbulojnë borxhet doganore dhe detyrimet të tjera në lidhje me mallrat, të cilat përbëjnë një rast të veçantë, përderisa natyra e procedurave është ndërkombëtare dhe shuma e kërkuar duhet të përshtatet në varësi të rrezikut dhe

seriozitetit të përgjegjës; si rrjedhojë është e domosdoshme të përshtatet neni 192 i Kodit;

- (8) Duke pasur parasysh se sipas formulimit aktual të nenit 215 të Kodit, është e mundur që të përcaktohet se ku është shkaktuar borxhi doganor, por kjo nuk tregon se ky vend përcakton autoritetin përgjegjës për hyrjen e borxhit në llogari; për më tepër, kur nuk shfuqizohet procedura doganore atëherë rregulli që përcakton vendin duhet të ndryshohet për të pasqyruar nevojën për të përcaktuar vendin se ku kanë ndodhur ngjarjet nga të cilat rrjedhin borxhet doganore;
- (9) Duke pasur parasysh se thjeshtimi dhe qartësimi i rregullave për përfitimin e operatorëve dhe nëpunësve doganore përbëjnë një pjesë kryesore të planit të veprimit për kalimin transit doganor në Europë; këto rregulla, gjithashtu, duhet të zbatohen te klauzolat e përcaktuara në përputhje me procedurën e komisionit;
- (10) Duke pasur parasysh se, ky ndryshim i Kodit bashkë me ndryshimet korresponduese të dispozitave të tij zbatuese, duhet të lehtësojë paraqitjen në drejtimin e duhur të një sistemi të ri të kompjuterizuar të kalimit tranzit për përfitimin e interesave publike që rrezikohen në operacionet tranzit si dhe për përfitimin e operatorëve ekonomike,

KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Rregullorja (KEE) nr 2913/92 është ndryshuar si më poshtë vijon:

1. Neni 91(1)(b) do të zëvendësohet si vijon:

“(b) Mallrat e Komunitetit, në rastet dhe në kushtet e përcaktuara në përputhje me procedurën e Komisionit, duhet të mos lejojnë produktet që mbulohen dhe përfitohen nga masat e eksportit si nga shkelja apo përfitimi i paarsyeshëm nga këto masa”.

2. Neni 92 do të zëvendësohet si vijon:

“Neni 92

1. Procedura e kalimit transit të jashtëm duhet të përfundojë edhe detyrimet e mbajtësit duhet të përmbushen kur të paraqiten mallrat sipas procedurës dhe dokumenteve të kërkuara në zyrën doganore të destinacionit, në përputhje me klauzolat e procedurës në fjalë.
 2. Autoritetet doganore duhet ta shfuqizojnë procedurën kur ata ndodhen në pozitën për të vendosur se procedura ka përfunduar me saktësi mbi bazën e krahasimit të të dhënave në dispozicion të zyrës së nisjes (nga ku janë nisur mallrat) dhe të dhënave në dispozicion të zyrës së destinacionit (ku mbërrijnë mallrat).
3. Neni 94 do të zëvendësohet si vijon”.

“Neni 94

1. Kryetari ose përgjegjësi duhet të sigurojë një garanci, me qëllim që të sigurojë pagesën e çdo borxhi doganor apo detyrimi tjetër në lidhje me mallrat.

2. Garancia duhet të jetë ose:
 - (a) një garanci individuale që mbulon një operacion të vetëm tranzit; ose
 - (b) një garanci gjithëpërfshirëse që mbulon një sërë operacionesh tranzit ku kryetari është autorizuar për ta përdorur këtë garanci nga autoritetet doganore të Shteteve Anëtare ku ai është vendosur.
3. Autorizimi i referuar në paragrafin 2 germa (b) duhet t'u jepet vetëm personave të cilët:
 - (a) janë vendosur në Komunitet ;
 - (b) janë përdorues të rregullt të procedurave tranzit të Komunitetit ose të cilët njihen nga autoritetet doganore si persona që janë të aftë të përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me këto procedura dhe;
 - (c) nuk kanë kryer shkelje serioze ose të përsëritura ndaj ligjeve të doganës apo të taksave.
4. Personat që sigurojnë autoritetet doganore se ata përmbushin standarde të larta serioziteti mund të autorizohen për të përdorur një garanci gjithëpërfshirëse për një shumë të reduktuar ose të kenë mundësinë që të heqin dorë nga garancia. Kriteret shtesë për këtë autorizim përfshijnë:
 - (a) Përdorimin e saktë të procedurave të kalimit tranzit të Komunitetit gjatë një periudhe të caktuar;
 - (b) Bashkëpunimin me autoritetet doganore dhe;
 - (c) Në lidhje me heqjen dore nga garancia, një mbështetje e mirë financiare e cila është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e personave të përmendur.
Rregullat e detajuara për autorizimet e dhëna sipas këtij paragrafi duhet të përcaktohen në përputhje me procedurën e komisionit.
5. Heqja dore nga garancia e autorizuar në përputhje me paragrafin 4 nuk duhet të zbatohet tek operacionet e kalimit tranzit të jashtëm të Komunitetit, të cilat përfshijnë mallra që konsiderohen si mallra që paraqesin rrezikshmëri në rritje, në përputhje me procedurën e komisionit.
6. Në ndjekje të parimeve që ndodhen në paragrafin 4, mbështetja te një garanci gjithëpërfshirëse për një shumë të reduktuar mund të ndalohet përkohësisht nga procedura e komisionit, si një mase e veçantë në rrethana të veçanta, në rastin e kalimit tranzit të jashtëm nga komuniteti.
7. Në ndjekje të parimeve që ndodhen në paragrafin 4, mbështetja te një garanci gjithëpërfshirëse mund të ndalohet përkohësisht nga procedura e komisionit, në lidhje me mallrat të cilat, duke qenë të përfshira në këtë garanci, janë identifikuar si mallra që janë pre e një shkalle të gjerë mashtrimi, në rastin e kalimit tranzit të jashtëm nga komuniteti".

Neni 95 do të zëvendësohet si vijon:

“Neni 95

1. Përveç rasteve kur është e nevojshme në përputhje me procedurën e komisionit, nuk duhet të jepet asnjë garanci për:
 - (a) udhëtimet ajrore;
 - (b) transportin e mallrave në Rhine dhe në ujërat e lundrueshme të Rhine;
 - (c) transportin me tubacione nafte;
 - (d) operacionet e kryera nga kompanitë hekurudhore të Shteteve Anëtare.

2. Rastet në të cilat mund të hiqet dorë nga dhënia e garancisë në lidhje me transportin e mallrave në rrugë ujore, ndryshe nga ato të përmendura në paragrafin (b), do të vendosen në përputhje me procedurën e komisionit”.
5. Neni 97 do të zëvendësohet si vijon:
“Neni 97
1. Rregullat e detajuara për zhvillimin e procedurës dhe shfuqizimet do të vendosen në përputhje me procedurën e komisionit.
 - (a) Shtetet anëtare kanë të drejtë të përcaktojnë ndërmjet njëra-tjetrës procedura të thjeshtësuara në përputhje me kriteret që vendosen sipas rrethanave dhe që zbatohen për lloje të caktuara të mallrave të qarkullimit ose për sipërmarrje të veçanta.
 - (b) Çdo Shtet Anëtar ka të drejtë të vendosë procedura të thjeshtësuara, në rrethana të veçanta ,për mallrat për të cilat nuk kërkohet që të lëvizin në territorin e një shteti tjetër anëtar.
 3. Procedurat e thjeshtuara të përcaktuara sipas paragrafit 2, i transmetohen Komisionit”.
6. Në nenin 192 pika 1, fjalia hyrëse zëvendësohet si më poshtë:
“1. Aty ku legjislatura doganore e bën të detyrueshme për efekt sigurie dhe në bazë të klauzolave të veçanta të përcaktuara për kalimin transit në përputhje me procedurën e komisionit, autoritetet doganore duhet të caktojnë masën e kësaj sigurie në një nivel të barabartë më”.
7. Neni 215 do të zëvendësohet si vijon:
“Neni 215
1. Borxhi doganor shkaktohet:
 - Në vendin ku ndodh ngjarja nga e cila lind ky borxh;
 - Nëse nuk është e mundur të përcaktohet vendi ku lind borxhi , atëherë ai përcaktohet aty ku autoritetet doganore nxjerrin përfundimin se mallrat ndodhen në një situatë ku mund të shkaktohet borxhi;
 - Nëse mallrat i janë nënshtruar një procedure doganore, e cila nuk është shfuqizuar dhe nëse vendi nuk mund të përcaktohet në bazë të kërkesës së parë ose të dytë për furnizim brenda një periudhe të caktuar kohore, nëse është e përshtatshme në përputhje me procedurën e komisionit, ose në vendin ku mallrat i janë nënshtruar procedurës në fjalë, ose në vendin ku mallrat janë paraqitur në territorin doganor të Komunitetit ,sipas kësaj procedure.
 2. Kur informacioni i vënë në dispozicion të autoriteteve doganore u jep mundësi atyre të përcaktojnë , se borxhi doganor u shkaktua kur mallrat ishin në një vend tjetër, në një datë më të hershme, atëherë borxhi doganor mendohet që të jetë shkaktuar në vendin, i cili mund të përcaktohet si vendndodhja e mallrave para datës kur është përcaktuar ekzistenca e borxhit doganor.

3. Autoritetet doganore, të përmendura në nenin 217 pika 1, janë autoritetet e Shteteve Anëtare ku është shkaktuar borxhi doganor ose ku mendohet të jetë shkaktuar në përputhje me këtë nen”.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tretë, pasi është botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 13 Prill 1999.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

J.M. Gil-Robles

Për Këshillin

Presidenti

L. Schomerus

[1] GZ C 337, 07.11. 1997, fq. 52

[2] GZ C 73, 09.03.1998 fq. 17.

[3] Opinioni i Parlamentit Evropian i datës 13 maj 1998 (GZ C 167, i datës 1.6.1998, fq. 99), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 24 shtator 1998 (GZ C 333, 30.10.1998, fq. 65) dhe Vendimi i Parlamentit Evropian, datë 16 dhjetor 1998 (GZ C 98, 09.04.1999). Vendimi i Këshillit, datë 29 mars 1999.

[4] GZ L 302, 19.10.1992, fq. 1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 82/97 (GZ L 17, 21.1.1997, fq. 1)

Deklaratë e përbashkët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit.

Në lidhje me Nenin 3

Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni njohin rëndësinë e kërkesave për parandalimin e dëmtimit të rrjetit ose të funksionimit të tij, të cilët mund të shkaktojnë një dobësim të papranueshëm të shërbimit, duke marrë parasysh veçanërisht nevojën për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

Prandaj, ata vënë re se Komisioni do të kryejë një vlerësim të vazhdueshëm të situatës , me qëllim që të vlerësojë nëse ky është një rrezik që paraqitet shpesh dhe në një rast të tillë, të gjejë zgjidhjen e përshtatshme brenda kuadrit të procedurës së komitetit të përcaktuar në nenin 15.

Një zgjidhje e tillë, nëse është e përshtatshme, do të konsistojë në zbatimin sistematik të kërkesave themelore të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 3, pika b.

Përveç kësaj, Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni deklarojnë se procedura e përshkruar më sipër, zbatohet pa kufizuar mundësitë e përcaktuara në nenin 7, paragrafi 5 dhe zhvillimin e certifikimit dhe rregullave të shënimit vullnetarë, që synojnë të ndalojnë dobësimin e shërbimit dhe çdo dëmtim të rrjetit.